



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Primiëno/Prodato Received/Delivery | 21.10.2022 | viti god year | |
| Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKAMSHICK | 6384/2022 | | 115 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.741/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.741/2022 të datës 29.08.2022 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adresë: Komuna e Prishtinës, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.741/2022 e datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. DETYROHET Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ta emëroj ankuesin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese në kuadër të Shërbimit Civil.

III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, poashtu ankuesit t'ia bëjë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga data 06.08.2022 në ekuivalencë me pagën për kategori të mesme drejtuese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi e deri në zbatimin e të njëjtit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi, sipas Vendimit me shifër Nr.10/102 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 07.05.2019 është rriemëruar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa për shkak të skadimit të mandatit dhe mos emërimit nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 29.08.2022.

Në ankesën e parashtruar në Këshilli, ankuesi pretendon se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e mos emërimit të tij në pozitë të kategorisë së mesme drejtuese në kuadër të shërbimit civil, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, respektivisht nenit 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe ka shkelur parimet e përgjithshme të vazhdimësisë në detyrë të përcaktuara me nenin 7 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, me kërkesën që këshilli të obligojë Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ta emërojë ankuesin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese si dhe t'ia kompensojë pagën ankuesit nga datat 06.08.2022 deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kryetari i Këshillit, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit bazuar në aktet e brendshme normative, me datë 11.10.2022 përmes vendimit me numër VK.nr.112/2022 ankesës së ankuesit me shifër A.nr.741/2022 të datës 29.08.2022 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për 10 (dhjetë) ditë, ditë punë për shkak të specifikave të lëndës dhe nevojës së shqyrtimit të mëtejshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendosjes meritore në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5008/2022 të datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim për avokatin e datës 26.08.2022; Akt emërim për Nr.0/2 refe.E-301 e datës 21.11.2011; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit për e datës 19.02.2013; Vendim i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Nr.08/140 e datës 05.04.2017; Vendim i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Nr.10/102 e datës 07.05.2019; E-mail nga e datës 12.05.2022; E-mail nga S.S drejtuar Sh.L e datës 18.02.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë me nr.prot.5162/2022 e datës 06.09.2022; E-mail nga Arkiva e MPB drejtuar Këshillit e datës 16.09.2022; E-mail nga Arkiva MPB drejtuar S.A e datës 15.09.2022; Përgjigja në ankesë e datës 15.09.2022; E-mail nga Sh.L drejtuar A.K e datës 08.08.2022; E-mail me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-3 faqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është *e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi, sipas Aktit të Emërimit të datës 21.11.2011 me shifër refe. E-301 ka qenë i emëruar Udhëheqës i Divizionit për Integritime Evropiane, ndërsa sipas ndryshimit dhe plotësimit Aktit të Emërimit të datës 19.02.2013 është emëruar Udhëheqës i Divizionit për bashkëpunim Ndërkufitar në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Po

ashtu, ankuesi me Vendimin me numër:08/140 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 05.04.2017 ka qenë i emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa përmes Vendimit të datës 07.05.2019 me numër:10/102 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me mandat tre (3) vjeçar, respektivisht sipas vendimit të fundit për emërim mandati i tij ka përfunduar me datë 06.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, përmes e-mailit zyrtar të datës 18.02.2022 e ka njoftuar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik se ankuesit me datë 06.05.2022 i përfundon mandati, ndërsa me datë 12.06.2022 përmes e-mailit po ashtu e ka njoftuar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve publik se me datë 06.05.2022 në datën kur ankuesit i ka përfunduar mandati, në pozitën e Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës në cilësi të Zëvendësuesit është caktuar një tjetër zyrtare nga ana e Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, përmes e-mailit me datë 08.08.2022 e ka njoftuar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë se meqenëse ankuesit e ka përfunduar afati kohor prej 3 (tre) muajsh prej përfundimit të mandatit, i njëjti do të procesohet në listën e pagave me 0 (zero) pagesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 42 paragrafi 7, 8 dhe 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik Ku përcaktohet se: *"7.Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale. 8. Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil. 9. Gjatë periudhës 3 mujore në pritje të emërimit, nëpunësi mund të konkurrojë për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, përveç asaj për të cilën i ka mbaruar mandati"* dhe ka konstatuar se Njësia e Pranimit, në rastin konkret Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik është i obliguar sipas detyrës zyrtare të emëroj ankuesin brenda afatit kohor prej tre (3) muajsh prej momentit kur të njëjtit i përfundon mandati i emërimit në pozitë të kategorisë së Lartë Drejtuese në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe bazës ligjore të dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se sipas Vendimit të datës 07.05.2019 me numër:10/102 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ankuesi është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me mandat tre (3) vjeçar, respektivisht mandati i tij ka përfunduar me datë 06.05.2022, ndërsa ankuesi në pajtimin nenit 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"7. Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale. 8. Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të*

këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil" është paguar në afatin prej 3 (tre) muajsh pas përfundimit të mandatit, respektivisht nga data 06.05.2022 deri me datë 06.08.2022, mirëpo nga shkresat e lëndës të ofruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 16.09.2022, konfirmohet fakti se i njëjti përveç se nuk është emëruar sipas obligimeve ligjore që rrjedhin sipas detyrës zyrtare të përcaktuara me nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, të njëjtit që nga data 06.08.2022 kur edhe janë bërë 3 muaj nga kur i ka përfunduar mandati, lista e pagave për ankuesin procesohet me zero (0) të vlerës monetare.

Kolegj për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave thekson faktin se vonesat për emërim nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe zgjatja e afateve të tyre jashtë atyre që ka përcaktuar ligji material është veprim që bie ndesh me parimet e Shërbimit Civil të përcaktuara si në nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", madje vonesat e tilla për emërim e të cilat nuk varen nga kërkesat e palëve, por obligimet rrjedhin sipas detyrës zyrtare e bëjnë përgjegjëse Njësinë e Pranimit respektivisht Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrinë e Punëve të Brendshme edhe për kompensimin e dëmit material në rastin e caktuar.

Ndërlidhur me të gjeturat e përcaktuara si më sipër në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik është i obliguar që ta emërojë ankuesin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese në kuadër të shërbimit civil siç përcaktohet me nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa obligohet po ashtu që ankuesit t'ia bëjë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive nga data 06.08.2022 deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi në ekuivalencë apo barasvlerë me pagën për kategori të mesme drejtuese.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.741/2022, datë 21/10/2020

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit-Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik/MPB
- Arkivit të KPMSHCK-së